Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada – Government*

*Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit*
*Ministarstvo Infrastrukture i Sredine*
*Ministry of Infrastructure and Environment*

*Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister*

Nr: 104
Data: 18.03.2020

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit, dukë u bazuar në nenin 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 10 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazet Zyrtare, Nr.7,01 Mars 2019), nenin 8 (paragrafi 1.4.) të Rregullores Nr.05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, (Gazeta Zyrtare, nr.01/19.02.2020), nenit 4 paragrafit 2.2. dhe neni 25 dhe 36 të Ligjit Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/07 të datës 11.03.2020 nxjerr këtë:

# VENDIM

I. Operatorëve të transportit iu lejohet të kontraktojnë bartjen e punëtorëve me autobus ndërmjet vendbanimeve të Republikës së Kosovës dhe punëtorisë dhe anasjelltas, përveç zonave për të cilat Qeveria e Republikës së Kosovës vendos ndryshe, varësisht nga situata;

II. Autobusët që përdoren për bartjen e punëtorëve sipas pikës I të këtij Vendimi duhet të dezinfektohen dhe të ajrosen në mënyrë të rregullt.

III. Punëtorët në autobus duhet të pajisen me mjete mbrojtëse personale dhe të mbajnë distancë larg njëri tjetrit së paku një (1) metër.

IV. Operatorët ekonomik nga pika 1 e këtij Vendimi duhet të dëshmojnë se
   a) Kanë kontraktuar për veprimtarinë e cekur me lart
   b) Ta mbajnë listën e punëtorëve ne autobus

V. Ky Vendim zbatohet në përputhje me të gjitha vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emergjencën e shëndetit publik.

VI. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Vendimi i dërgohet*:**

- *Sekretarit të Përgjithshëm*
- *Departamentit të Transportit Rrugor;*
- *Kabinetit të Ministrit,*
- *Arkivit të Ministrisë*

**Lumir Abdixhiku**

Ministër i MIA